

VENDIM
Nr. 647, datë 27.8.2026

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. EMILJANO MENE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr.36, datë 21.1.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2026”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Emiljano Mene, në masën 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.
 2. Ky fond përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
 3. Pagesa bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.
 4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Albana Koçi